

01-1628

REPUBLIKA E KOSOVËS



Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 5 pika 1.2 dhe 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr.35/02-118069/24 dt.06.09.2024, të aplikuesit Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, rr. “Radovan Zogoviq”, nr. 1, në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për lejimin e rindërtimit të ndërtesës ekzistuese shkollore SHM “Ali Sokoli” në Prishtinë, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re Zona Perëndim”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit Komuna e Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 05.12.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore aplikuesit Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, sipas kërkesës 05 Nr.35/02-118069/24 dt.06.09.2024, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për lejimin e rindërtimit të ndërtesës SHM “Ali Sokoli” në Prishtinë, me etazhitet P+1, konkretisht ndërtimin e shtojcë-aneksit, me etazhitet P+1, në bllokun urban “A-5”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re Zona Perëndim”, në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të pjesës së parcelës kadastrale nr.10004-0, ZK Prishtinë.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, në kuadër të të cilës shtrihet ndërtesa ekzistuese, për rindërtimin e së cilës caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, rregullativës ligjore, procedurave të zhvilluara dhe të miratuara, përfshihet në kuadër të:

I. Planit Rregullues “Prishtina e Re Zona Perëndim”, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-186850 dt.02.10.2013, në zonë me destinim publik (Qendra edukative (SH-5)-qendra ekzistuese edukative, mirëmbajtja dhe rikonstruimi i ndërtesave ekzistuese, mundësia për mbindërtime sipas kushteve të planit).

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit-parcelës kadastrale, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
- nr.10004-0 ZK Prishtinë.....S=41085m².....Komuna e Prishtinës.....“tokë jo pjellore”;

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës kadastrale është S=41085 m².

- E drejta pronësore-juridike është Komunale, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale me nr.10004-0,ZK.Prishtinë, aktualisht ka ndërtesë ekzistuese shkollore – SHM “Ali Sokoli”;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë:rrugë,ujë, kanalizim, elektrikë, etj;
- Terreni është i rrafshët;
- Qasja në parcelë kadastrale bëhet përmes rruga ekzistuese rr.“Fehmi Lladrovci”, me gjendje faktike rrugë e asfaltuar;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa shkollore.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin/rindërtimin e ndërtesës shkollore SHM “Ali Sokoli”, në kuadër të zonës të Planit Rregullues “Prishtina e Re Zona Perëndim”, në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar, analizuar, si dhe

*është përcjeller për-ç
OSHO dt. 06.12.2024*

mbështetur në dokumentet e planifikimit hapësinor, projekt propozimin e prezantuar, gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe të ndërtesës dhe rregullativën ligjore në fuqi:

- Parcela ndërtimore, organizimi, gabariti, pozicionimi dhe etazhite i ndërtesës, qasja në kompleks si dhe raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, distancat në mes ndërtesave dhe nga kufiri i parcelës ndërtimore, rrugët dhe vend parkimet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të planifikohen sipas kriterëve të planit rregullues urban dhe kriterëve të përcaktuara në pikat e këtij paragrafi, duke u bazuar në “Plani i lokacionit-“zgjdhja urbane”, si dhe “Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues ” Prishtina e Re Zona Perëndim”, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Pjesa e parcelës kadastrale e trajtuar, në pjesën e bllokut urban me destinim publik (Qendra edukative (SH-5)-qendra ekzistuese edukative, mirëmbajtja dhe rikonstruimi i ndërtesave ekzistuese, mundësia për mbindërtime sipas kushteve të planit), për realizimin/rindërtimin e ndërtesës ekzistuese-ndërtimin e shtojcës/aneksit, që përfshihen në ndërtim-parcelë ndërtimore, konkretisht parcelat kadastrale të trajtuara brenda vijës rregulluese, është:

nr. 10004-0.....S=19,400 m²;

Sipërfaqe e përgjithshme e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese, është S=19,400 m²;

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të kompleksit me ndërtesë shkollore ekzistuese, në bllokun urban "Zonë për shfrytëzim nga bashkia ", planifikohet të rindërtohet ndërtesa shkollore ekzistuese, me sipërfaqe ndërtimore, mbi tokë dhe nën tokë, si në vijim:

Kompleksi me ndërtesë shkollore – rindërtimi i ndërtesës/aneks i SHM “Ali Sokoli”

Sipërfaqja ekzistuese: S=6,688.00m² / 5,016.00 m², mbi tokë + 1,672.00m², nën tokë /;

Etazhite: B+P+2

Sipërfaqja për rindërtim/aneks: S=1460.00 m² /1460.00 m², e tëra sipërfaqe mbi tokë /,

Etazhite: P+1;

Sipërfaqja e përgjithshme: S=8148.00m² / 6476.00m², mbi tokë+1672.00m², nën tokë /.

- Destinimi i shfrytëzimit të shtojcës-aneksit të ndërtesës shkollore, të jetë për hapësira shkollore, dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina për klasa, trapezari për ushqim, laboratorë, biblioteka, kabinete, teknike, depo, etj.;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelave kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelave brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën-gabaritin e përdhësës ose suteranit, është max.40%, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi me ndërtesë shkollore – rindërtimi i ndërtesës/aneks i SHM “Ali Sokoli”

S=19,400x0.4=7760.00 m² / lejuar sipas PRR-së /,

S=1672 m² /sipërfaqja e bazës/gabaritit të përdhësës së ndërtesës ekzistuese /;

S=730 m² / sipas projekt propozimit /;

S=1672+730=2,302m² / sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzimit të pjesës së parcelës kadastrale /.

- Koeficienti i minimal i parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ), bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-185481, është 40%, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi me ndërtesë shkollore – rindërtimi i ndërtesës së SHM “Ali Sokoli”

S=19,400x0.4=7760.00 m² / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit /;

S=9700.00 m² / sipas projekt propozimit /.

- Koeficienti i ndërtimit (TSK) për Bllokun Urban “A-5”, sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është 3.0, Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00, **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi me ndërtesë shkollore – rindërtimi i ndërtesës/aneksi i SHM “Ali Sokoli”

S=19400.00x3.0=58200.00 m² / lejuar sipas PRR-së /,

S=5016.00 m² /sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore e ndërtesës ekzistuese /;

S=1,460.00 m² / sipas projekt propozimit /.

Sipërfaqja e përgjithshme: 5016+1460=6476 m²

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e

"termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;

- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë $1.0 \times H$ (ku H , është lartësia e ndërtesës mbi tokë), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje $0.5 \times H$ ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlenë edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj);
- Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) te fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) lejohet që distanca të jetë $0.6 \times H$;
- Ngritja e nivelit të përdhës nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet të jetë max.1.2 m;
- Qasja në kompleksin e ndërtesës shkollore të jetë nga rruga ekzistuese;
- Bazuar në Udhëzimi Administrativ të MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, për ndërtesat e shkollave fillore parashihet 0.5 vendparkim/100 m². Për ndërtesat e sallave të sportive në kompleks të shkollës, kalkulohet vetëm hapësira e sallës.
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe rrugë qarkulluese-perimetrike, për qasje të zjarrfikësve si dhe shtigjet, sipërfaqet e pllakëzuara dhe vendparkimet e mjaftueshme për personel dhe frekuentues të tjerë;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

VI. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

VII. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, bazuar në "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dymëve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;

- Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

VIII. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për **Masat e mbrojtëse nga zjarri** hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë", për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për **Leje Mjedisore Komunale** hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

X. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr.10004-0 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "arë e klasës 3", kërkohet që paraprakisht të bëhet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11 dhe 13 të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën jo pjellore dhe nenit 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit -"zgjidhja urbane"-parcelës ndërtimore, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=19,400m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrat kadastral.

Bazuar në nenin 14, paragrafi 14.2, pika h të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nuk paguhet në rastet kur ndërtohen objekte shkollore dhe shëndetësore dhe objekte për raste sociale. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XI. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.



Aplikuesi Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, me kërkesën 05 Nr.35/02-118069/24 dt.06.09.2024, ka kërkuar nga kjo drejtori, caktimin e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për lejimin e rindërtimit të ndërtesës SHM "Ali Sokoli" në Prishtinë, me etazhitet P+1, konkretisht ndërtimin e shtojcës-aneksit, me etazhitet P+1, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën, 05 Nr.35/02-118069/24 dt.06.09.2024 dhe gjatë zhvillimit të procedimit administrativ të saj, aplikuesi ka prezantuar:

- Dëshminë mbi pronësinë kopja e planit për parcelën kadastrale nr.10004-0, evidentuar në Certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10004-0 ZK Prishtinë, në emër të Komunës së Prishtinës;
- Projektin konceptual-projekti ideor, propozimi i hartuar "Eko-Project", SHPK, me numër unik 810845662 me dt.29.01.2015, Prishtinë.

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës 05 Nr.35/02-118069/24 dt.06.09.2024, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, dokumentacionin e prezantuar si dhe provave tjera, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor të zonës/hapësirës ku gjendet lokacioni, Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, projekt propozimit – projektit konceptual të prezantuar me këtë kërkesë për caktim të kushteve ndërtimore, si dhe rrethanat dhe provat/faktet për vendosje, në mënyrë kronologjike, ka konstatuar se:

Parcela kadastrale nr.10004-0 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 41085 m², sipas certifikatës së njësisë kadastrale (tokë tjetër/jopjellore), përfshihet brenda kufijve të Planit Rregullues "Prishtina e Re Zona Perëndim", ndërsa pjesa e kësaj parcele, me sipërfaqe S=19400 m², që trajtohet me këto kushte ndërtimore, përfshihet brenda bllokut urban "A5", të Tërësisë Hapësinore "A", të këtij plani, në zonë me destinim publik (Qendra edukative (SH-5)-qendra ekzistuese edukative, mirëmbajtja dhe rikonstruimi i ndërtesave ekzistuese, mundësia për mbindërtime sipas kushteve të planit). Me kërkesën në trajtim Drejtoria e Arsimit, ka kërkuar caktimin e kushteve ndërtimore për lejimin e rindërtimit të ndërtesës, konkretisht ndërtimin e shtojcës-aneksit, me qëllim të plotësimit të nevojave për hapësirë për zhvillimin e procesit arsimor-edukativ në atë institucion.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 5 dhe 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13 të "Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-"zgjidhja urbane", është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Dispozita urbanistike-"zgjidhja urbane" me ndërtesë ekzistuese dhe atë të planifikuar për rindërtim.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror-MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05-350/02-118069/24 dt.06.09.2024.


Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit, dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-118069/24 DT. 05.12.2024

Zyrtari,
Gëzim Ferizi



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



SH.M.M " ALI SOLOLI		
Projekti :	PROJEKTI IDEOR	
Objekti :	Aneks Objekti P+1	
Baza:	Planimetria e Situacionit	
Vendi/ Viti:	Prishtinë / Nëntor 2022	
Formati :	Përpjesa :	1 : 100

